



Titulli i projektit

Rivitalizimi i fshatrave

Tipi i projektit

Shërbime Publike

Vendndodhja e projektit

Zona Funksionale Dibër (15 NJQV)

Buxheti i paravlerësuar

2,300,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Zona Funksionale e Dibrës ka në administrim 141 fshatra, që kanë qenë pjesë e 14 komunave. Në 20 vitet e fundit ka ndodhur një largim i madh nga fshatrat drejt qytetit të Peshkopisë dhe zonave të zhvilluara të Tiranës dhe Durrësit. Në vitin 1990 jetonin në fshat 86000 banorë, ndërsa sot jetojnë 60000 banorë. Pra rreth 43% e popullsisë është larguar.

Një nga arsytet më të mëdha të këtij largimi, përveç anës ekonomike, ka qenë edhe mungesa e shërbimeve në fshat, të tilla si rrugë të asfaltuara dhe sheshe. Këto mungesa ndikonin dhe në largësinë e banorëve me shërbimet e tjera bazë, si arsim, shëndetësi, tregje, punësim, etj.. Familjet që ndodhen në fshat dhe shumë familje të tjera që kanë shtëpitë, por nuk qëndrojnë gjatë gjithë sezonit, kanë investuar në shtëpitë e tyre dhe kanë krijuar ekonomi të formalizuara në fshat, duke bërë që vitet e fundit të kemi një stabilizim të ikjes nga fshati. Për më tepër, kemi një tendencë të frekuentimit dhe të kthimit të banorëve të larguar.

Me krijimin e NJQV së Dibrës si një njësi dhe me mos funksionimin e komunave, të krijohet përshtypja që fshati do të mbetet më larg shërbimeve të ofruara nga pushteti lokal. Prandaj është e nevojshme që të hartohet një program për rivitalizimin e fshatit, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin solid të fshatit. Duhet të rehabilitohen sheshet e qendrave të komunave që kanë qenë qendra krahinore, qendrat e fshatrave të mëdhenj që kanë 1500-2500 banorë. Gjithashtu, duhet të asfaltohen rrugët e fshatrave që janë 1-1.5 km nga aksi kryesor i rrugëve të asfaltuara, duke bërë në këtë mënyrë rivitalizimin e fshatit në zonën e Dibrës. Projekti është pjesë e analizës së shërbimeve të NJQV në seksionin për transportin dhe rrugët.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i përgjithshëm: Përmirësimi i cilësisë së jetesës për banorët e fshatrave të Dibrës, nëpërmjet rregullimit të kushteve dhe shërbimeve infrastrukturore në fshat.

Objekti specifik: Rivitalizimi i fshatrave të Dibrës, duke përmirësuar pamjen arkitekturore të fshatrave me sheshe të sistemuara dhe me vepra arti, të paktën për qendrat krahinore që kanë qenë ish-komuna dhe fshatrat e mëdhenj, si dhe me rrugë të asfaltuara, të paktën për fshatrat që janë 1-1.5km larg aksit kryesor të rrugës nacionale, brenda vitit 2019.

PROJEKTI 6



program i zonave funksionale

pzf

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultati i pritshëm 1: Fshatrat e Dibrës (12 qendrat krahinore dhe 8 fshatrat e mëdhenj) janë me sheshe të sistemuara, me vepra arti të ndërtuara dhe komuniteti ka kontribuar dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive.

Rezultati i pritshëm 2: 10 fshatrat e Dibrës që janë 1-1.5 km larg akseve rrugore kryesore të asfaltuara, janë me rrugë të asfaltuara dhe të sistemuara.

Aktivitetet e projektit

- 1 Hartimi projekteve teknike
- 2 Fushatë dialogimi me komunitetin e fshatrave.
- 3 Rehabilitimi i shesheve
- 4 Asfaltimi i rrugëve

Maturimi i projektit

Programi ka në tërësinë e tij disa projekte dhe është në fazën e konceptit. Për pjesën e projekteve të rrugëve, disa komuna kanë projektet e plota teknike, të cilat do të dorëzohen në inventarin e NJQV së ardhshme, me qëllim që të vazhdojnë fazën e aplikimit të mëtejshëm.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

NjQV e ardhshme është përgjegjëse për hartimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Fondet për rehabilitimin e shesheve mund të gjenerohen në një pjesë të madhe edhe nga kontributi i komunitetit ose bizneseve, ndërsa për rrugët ato do të thithen nga fondet qeveritare, si Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Bashkia do të bashkëpunojë ngushtë me komunitetin dhe bizneset që janë të gatshëm të sponsorizojnë, veçanërisht për rehabilitimin e shesheve.

Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është 2,300,000 Euro. Në këtë kosto janë futur 1,500,000 Euro për asfaltimin e rrugëve dhe rreth 800,000 Euro për rehabilitimin e shesheve.